



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

Anr.299/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Arsim Hamzaj - kryesues, Kymete Kicaj e Skender Çoçaj - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes, për Zgjedhjet e Përgjithshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09.02.2025, në seancën e panelit të mbajtur me datë 04.02.2025, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET e pabazuar ankesa Anr.299/2025, e datës 01.02.2025, Anr.300/2025, e datës 01.02.2025 dhe Anr.317/2025, e datës 02.02.2025, të parashtruara nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkak të shkeljes së Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët gjatë fushatës zgjedhore për Kuvendin e Republikës së Kosovës, që do të mbahen më datë 09 Shkurt 2025.

A r s y e t i m

Me datë 01.02.2025 dhe 02.02.2025, PZAP- i, ka pranuar disa ankesa përmes postës, nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje (LVV) me seli në Prishtinë, të parashtruar kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK), me seli në Prishtinë, për shkelje të Ligjit nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e përgjithshme dhe Kodin e Sjelljes së Subjekteve Politike, neni 34, paragrafi 1.11.

Në ankesën Anr.299/2025, pretendohet se me 1 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Skenderaj ka identifikuar mbështetësin e PDK-se Fahri Mahmutin përmes fotografisë ku ka krahasur deputeten e LV-se Mimoza Kusari me krye terroristin serb Milan Radoicic. Po ashtu në fotografinë numër 2, Kryeministrin Albin Kurit, kandidat i LVV për Kryeministër, e quan "tradhtari numër 1". PROVË: Fotografi dhe linqe ku dëshmohet përdorimi i gjuhës që nxit, provokon akt të dhunës apo urrejtjes , në kundërshtim me LZP-në. Në ankesën Anr.300/2025 pretendohet se 1 Shkurt 2025, Qendra e Lëvizjes VETËVENDOSJE në Skenderaj ka identifikuar shumë komente, të bëra në një fotografi të publikuar të Rita Augestad Knudsen,

bashkëshortes së Kryeministrit Albin Kurti, nga simpatizantë dhe mbështetës të subjektit politik PDK, si Fahri Mahmuti, Fazli Shala etj, të cilët kanë përdorur gjuhë fyese dhe denigruese për qëllime të fushatës dhe me qëllim të vazhdimit të dëmtimit elektoral dhe nxitjes së urrejtjes ndaj Kryeministrit Albin Kurti.

Në ankesën 317/2025, parashtruesi i ankesës pretendon se me datë 31 janar 2025, në ora 18: 30, në tubimin e PDK-së në Malishevë, Kryetari i Degës së Malishevës Mevludin Mazreku ka thënë " *Malisheva nuk është e asnjë individi, Malisheva dhe Kosova nuk është e atyre që për 4-5 vitet e fundit e degraduan shtetin 'e Kosovës'* .

Parashtruesi i ankesës pretendon de me këtë deklaratë z. Mazreku ka fyer, nxitur, degraduar, provkuar dhe nxitur urrejtje ndaj subjektin politik Lëvizja VETËVENDOSJE! dhe punën e Qeverisë së Kosovës.

Përmes këtij veprimi, subjekti përkatës, ka cenuar dispozitat përkatëse ligjore dhe rregullative, konkretisht nenin 34 par 1 nënpar 1.11 të Ligjit për Zgjedhjet (LZP). Po ashtu praktika gjyqësore e PZAP-së, konkretisht në vendimin Anr.211/2025, dënon gjuhen pothuajse identike që është përdorur nga kandidati Haxhi Avdyli.

Në përgjigjen në ankesa të subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës theksohet si në vijim: Ankesën A.nr.299/2025, Anr. 300/2025 dhe A.nr.301/2025 dhe në afatin et përcaktuar ligjor jep këto përgjigje:

PDK përmes kësaj përgjigje, kërkon nga PZAP që ankesat e ankuesit t'a refuzoj si të pabazuara për arsye se:

Fillimisht, para se të trajtojmë meritat e ankesës, e shohim si të rëndësishme për të shqyrtuar çështjen e afatshmërisë së ankesës, pasi që siç mund të vërehet, ankuesi nuk i ka bashkëngjitur si dëshmi asnjë provë me të cilën argumentohet koha në të cilën ka ndodhur shkelja e pretenduar, pasi që në vështrim të provës së bashkëngjitur, dëshmohet vetëm që postimi të jetë shpërndara para disa orësh, mirëpo nuk mund të vërtetohet koha se kur është bërë Screenshot, andaj si i tillë është e pamundur që të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar në ankesë.

.Në çështjen e njëjtë/identike, ku ankues ka qenë subjekti politik PDK, PZAP përmes vendimit A.nr. 147/2025, në pjesën arsyetuese ka konstatuar se "Paneli me raslin e shikimit të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që ngafotografitë e ofruara si dëshmi me te cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkëngjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese 'l. Andaj, në këtë kontekst, PZAP-së i propozojmë që të zbatoj standardin e njëjtë dhe rrjedhimisht ankesën e ankuesit ta refuzoj si të pabazuar.

Gjithsesi, edhe po të konsiderohet i mirëqenë fakti që ankuesi ka parashtruar ankesën në afat, vlerësojmë se ankesa si e tillë është e pabazuar për arsyet si në vijim:

PDK në asnjë mënyrë nuk e konteston faktin se veprimet e personave të cilët janë Objekt i kësaj ankese përbëjnë përdorim të gjuhës që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë një person tjetër për të layer një akt të dhunës kundër personave tjerë, për të cilat vlerësojmë se padyshim përbëjnë veprime të ndaluara.

Mirëpo, konsiderojmë se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoi përgjegjësinë subjektive ndaj subjektit politik PDK, pasi që Siç do të vërej kolegji i nderuar i panelit, ankuesi me asnië provë

nuk ka arritur që të bëi ndërlidhien e veprimeve të personave të përmendur në ankesë, me përgjegjësinë e subjektit politik PDK, mirëpo është mjaftuar vetëm me pretendimin se të njëjtit janë mbështetës dhe aktivistë të PDK-së.

Gjithashtu, PDK ka bërë kërkim në rrjetin social Facebook të profileve të personave të lartcekur, në të cilën ka vërejtur se profili i z. Fahri Mahmuti, i cili ka të postuar gjithsejt 8 foto në këtë profil, asnjërin prej tyre të veten, e cila qartazi nënkupton se ky profil është falls dhe jo real dhe për më tepër në një fotografi të shpërndarë nga ana e tij shihet se ka publikuar një paralajmëium për debatin e kandidatit nga radhët e lidhjes demokratike të Kosovës z. imri ahmeti në televizionin kanal 10. si më sipër, është e paoartë se cfarë përgjegjësie subjektive mban subjekti politik pdk me veprimet e z. fahri mahmuti 1 cili për më tepër në profilin e tij ka shpërndarë edhe paralajmëium për debat televizivë tij z. imri ahmeti - kandidat për deputet nga radhët e LDK-së.

Andaj, bazuar në nenin 118 (vendimet), par.1 të LZP-së, PZAP-së i ka propozuar që të REFUZOHET si e pabazuar ankesa A.nr.299/2025, A.nr.300/2025, A.nr.301/2025 të parashtruar nga subjekti politik Lëvizja Vetëvendosje dhe të KONSTATOHET se ankuesi nuk ka arritur që të argumentoj përgjegjësinë subjektive të PDK, të mbështetur në dëshmi të qarta dhe bindëse.

Paneli, në kuptim të nenit 9 paragrafi 5, nën paragrafi 5.5 të Rregullores Nr.01/2024, për Procedurat e Parashtrimt dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, dhe nenit 84 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031, për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me qëllim të ekonomizimit të procedurës, ankesat e evidentuara me numrat si ne vijim: Anr.299/2025, Anr.300/2025, të datës 01.02.2025 dhe Anr.317/2025, të datës 02.02.2025, janë bashkuar dhe janë trajtuar me një vendim, andaj procedimi i këtyre ankesave evidentohen nën shenjë e përbashkët A.nr.299/2025, për shkak të natyrës së njëjtë të çështjeve të parashtruara nga subjekti i njëjtë politik LVV kundër subjektit të njëjtë politik PDK, si për nga përmbajtja ashtu edhe për nga kërkesat e paraqitura të ankesave.

Paneli pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se :

-Ankesa është e pabazuar.

Paneli pas shikimit të shkresave të lëndës dhe përgjigjes në ankesë të paraqitur nga subjekti politik PDK, vlerësoj se pretendimet e subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin shkelje të dispozitës së nenit 34 paragrafi 1 nën paragrafi 1.11, të LZP-së, me të cilën përcaktohet: “Gjatë periudhës së fushatës, subjekti politik, mbështetësit ose kandidatët e tij, ndalohen nga bërja e ndonjëres si në vijim: *përdorimi i gjuhës, në formën e shkruar ose gojore, që nxit ose provokon, ose që mund të nxisë ose provokojë, një person tjetër për të kryer një akt të dhunës kundër personave tjerë ose pasurisë, ose e cila nxit apo mund të nxisë urrejtje kundrejt të tjerëve ose duke publikuar ose përdorur fotografi, simbole ose çfarëdo materiali tjetër që ka ose mund të ketë ndikim të tillë*”.

Pretendimet ankimore të parashtruesit të ankesës lidhur me shkeljen e pretenduar nga ana e subjektit politik PDK, Paneli i vlerësoj se janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se veprimet e përshkruara në ankesë nuk paraqesin ndonjë nga shkeljet e pretenduara, kjo

pasi që parashtruesi i ankesës, në ankesë e ka bashkangjitur postimet e personave në fjalë, mirëpo me asnjë provë nuk ka mundur të vërtetohet se të njëjtit janë mbështetës apo aktivist të PDK-së. Ndërsa në deklarinimin e Kryetarit të Degës së PDK-së në Malishevë Mevludin Mazreku se *"Malisheva nuk është e asnjë individi, Malisheva dhe Kosova nuk është e atyre që për 4-5 vitet e fundit e degraduan shtetin 'e Kosovës"*, sipas vlerësimit të Panelit është në përputhje me diskursin e fushatës zgjedhore dhe i njëjti nuk ka fyer, fyer, degraduar apo urrejtje ndaj subjektit politik Vetëvendosje apo të Qeverisë së Kosovës dhe nuk përbën shkelje të rregullave zgjedhore.

Paneli me rastin e shikimit të shkresave të lëndës, vlerësoi se ankesa është e pabazuar pasi që nga provat e ofruara si dëshmi të cilat parashtruesi i ankesës i ka bashkangjitur si dëshmi, nuk mund të vërtetohet se në cilën kohë ka ndodhur shkelja e pretenduar për të cilën referohet pala ankuese. Andaj duke u mbështetur në nenin 117.3 të LZP-së ku përcaktohet se: *"vendosja për ankesat nga PZAP-ja mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse"*, Paneli vlerësoj se pretendimet e tilla janë të pa qëndrueshme dhe si të tilla i refuzoj, për faktin se nga veprimet e përshkruara në ankesa dhe nga provat e ofruara si dëshmi parashtruesi i ankesave nuk ka arritur që të vërtetoj pretendimet e theksuara si më lart.

Nga arsyet e theksuar më lartë duke bazuar nenin 117 paragrafi 3, neni 118 paragrafi 1 të LZP-së, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa

Anr. 299/2025 më datën 04.02.2025

**Kryesues i Panelit,
Arsim Hamzaj**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimimit të këtij vendimi.